VENDIM
Nr. 912, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E *PERSONELIT* TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN "RSM" TË NATO-S, PRANË KOMANDËS SË BATALIONIT SHUMËKOMBËSH, NË AFGANISTAN[1]

(Ndryshuar me VKM nr.283, datë 21.5.2018, nr. 822, datë 18.12.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të *personelit* të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga *33 (tridhjetë e tre)* ushtarakë, pranë Komandës së Batalionit Shumëkombësh, në varësi të Shtabit të Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Kabul (TAAC - Capital), në Afganistan.

2. Misioni i *personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë* është ruajtja e Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në kuadër të operacionit të NATO-s "RSM", në Afganistan.

3. *Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024.* Periudha e qëndrimit në mision për çdo *kontingjent* do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Venddislokimi i *personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë* të jetë në Aeroportin Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në Afganistan.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së ope-racionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

ë) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit, që do të shërbejë në Afganistan, dërgimi, ndërrimi dhe kthimi pas përfundimit të detyrës për në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

---

[1] VKM nr. 912, datë 22.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.204, datë 7 janar 2014.
VKM nr.283, datë 21.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare 76, datë 28 maj 2018.